



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6 Prill 2022

Nr. 141

V E N D I M
P Ë R

VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE DAKTILOSKOPIKETË MBLEDHURA NGA PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Në mbështetje të neneve 14, 19, shkronja “n”, pikat 1 e 2, dhe 167/2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I M:

1. Procesi i verifikimit të të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Durrës, Dibër, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, bëhet nga administrata e KQZ-së për identifikimin e rasteve të dyshuara të votuesve të shumëfishtë.
2. Në përfundim të verifikimit hartohet raporti paraprak, të cilin Sekretari i Përgjithshëm ia paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Raporti paraprak i dërgohet për njohje subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në procesin e këqyrjes, të cilat brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të parashtrojnë komentet e tyre.
4. Raporti përfundimtar për këqyrjen e të dhënave PEI miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
5. Ngarkohet administrata e KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

